

VENDIM
Nr.63, datë 13.6.2008

**MBI APLIKIMIN E SHOQËRISË “ERS-08” SHPK PËR LICENCIMIN NË
AKTIVITETIN E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË
CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA PARKU EOLIK KAVAJË**

Në mbështetje të neneve 9, 13, pikat 1 germa “a”, dhe 8, si dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, 13, pika 1 dhe 2, si dhe 14, të “Rregullores për procedurat e licencimit”, miratuar me vendimin nr.24, datë 4.4.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.6.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ERS-08” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike, nga parku eolik Kavajë,

konstatoi se:

1. Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të ERS-08 sh.p.k., ka nisur me marrjen e vendimit nr.29, datë 4.3.2008.

2. Ligji nr.9913, datë 5.5.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike””, nuk mund të ketë fuqi prapavepruese për aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Në lidhje me ndërtimin e këtij parku, shoqëria ERS- 08 sh.p.k., në aplikimin e saj për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike, e bazon studimin e prefizibilitetit në të dhëna historike të regjistruara të ERE-s, të matura në lartësi të ndryshme nga ato në të cilat do të punojnë gjeneratorët.

4. Ligji për sektorin e energjisë elektrike parashikon në nenin 15 autoritetin e ERE-s për vendosjen e kushteve të çdo licence.

Për sa konstatuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “ERS-08” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga Parku Eolik Kavajë me kusht zbatimin përveç sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, edhe të zbatimit të kushteve të mëposhtme:

a) Kryerjen e një studimi fisibiliteti, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Përcaktimi në këtë studim i kostos së prodhimit të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE brenda 12 muajve nga data e lëshimit të licencës dhe përpara fillimit të zbatimit të punimeve. Për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve.

b) Shoqëria “ERS-08” sh.p.k. duhet paraqesë pranë ERE-s, marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara detyrimet e ndërsjella, që rrjedhin nga kodi i transmetimit.

c) Shoqëria “ERS-08” sh.p.k. do të respektojë detyrimet e shërbimit publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

d) Koha e zbatimit e të gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke iu

referuar datës së lëshimit të licencës të jetë 36 muaj.

e) Mospërbushja e pikave të mësipërme në afatet e përcaktuara e bën licencën të pavlefshme.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta